



Pranuar / Dorezuar Received / Delivered	28.12.2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	7712/2023	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Koliciteta Quantity
SKAMBICK			1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1383/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar Malsore Gashi -Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj - Demi, anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1383/2023 të datës 06.11.2023 të parashtruar nga ankuesi të përfaqësuar me autorizim nga Avokat me adrese banimi kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.1383/2023 e datës 06.11.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. ANULOHEN vendimi i datës 16.10.2023, Njoftimi i datës 03.11.2023 dhe 06.11.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Prishtinës, si dhe të gjitha veprimet administrative që ndërlidhen me konkursin me numër reference RN00012299 të datës 01.08.2023, nga faza e verifikimit paraprak.
- III. OBLIGOHET, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, që në lidhje me konkursin me numër reference RN00012299 të datës 01.08.2023 për emrin e grupit "Specialist i Shkencave Shoqërore", për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2", pesë (5) pozita, të ndërmarrin veprimet konform përgjegjësisive me qëllim që të rifillohet procedura në lidhje me këtë konkurs nga faza e verifikimit paraprak të kandidatëve.

IV. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prishtinës, të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

(tani e tutje referuar si ankuesi), sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit për grupin Specialistë i Shkencave Shoqërorë, gjegjësisht për pozitën "Zyrtar për Shërbimet Sociale 2", pesë (5) pozita të publikuar nga Komuna e Prishtinës, me datë 06.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6876 të regjistruar nën shenjë A.nr.1383/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin për shkelje të dispozitave materiale, procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (më tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Prishtinës, ndërsa me datë 20.11.2023, dhe me datë 11.11.2023 nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, më datë 18.12.2023 Kryetarit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendim për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (më tutje Kolegji i këshillit), me rastin e kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1383/2023 të datës 06.11.2023, drejtuar KPMSHC-së; Njoftimi i datës 06.11.2023;E-maili i datës 06.11.2023;Njoftimi i datës 03.11.2023;Diplomë me numër protokoll 2343, e datës 14.09.2023;Ankesë e datës 25.10.2023, drejtuar Komisionit të Pranimit; Njoftimi i datës 24.10.2023;Rezultati i vlerësimit, në SIMBNJ, Rezultati i verifikimit paraprak, Rezultatet përfundimtare, Konkursi i datës 10.08.2023;Autorizimi i datës 24.10.2023; Vendimi me numër protokoll 14-020/04-0197412/23, i datës 26.09.2023;Njoftimi i datës 06.11.2023;Renditja përfundimtare e kandidateve; Aplikacioni i ankuesit, me shkresat e bashkangjitura; Njoftimi i datës 14.09.2023; Lista e aplikantëve; Vendimi e datës 16.10.2023, i Komisionit për Vlerësim; Lista e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; E-maili i datës 12.10.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 1338/2023, e datës 20.11.2023, si dhe plotësimi përgjigjes në ankesë me numër protokoll 1383/2023, e datës 11.12.2023.

Kolegji i këshillit, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, me datë 10.08.2023 (afati për aplikim 31.08.2023-07.09.2023) ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00012299 për grupin e pozitës Specialist i Shkencave Shoqërore, për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2", pesë(5) pozita, ndërsa kriteret e konkursit për pozitë kanë qenë:

- **Arsimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK)
- **Kualifikime të posaçme formale:** Fakulteti i Punëve Sociale, Psikologji, Sociologji, Pedagogji, Antropologji, Fakulteti Juridik dhe Ekonomik.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Se paku (1) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës konstaton se përmes vendimit të datës 16.10.2023 nga komisioni i pranimit ankuesit i është pamundësuar vazhdimi i procedurave të regrutimit për këtë pozitë, me arsyen se i njëjti me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur diplomën universitare por se ka bashkangjitur certifikatën e diplomimit, ndërsa në këtë vendim nuk kishte këshill juridike që ankuesit do ti mundësohej të ushtroj mjetet juridike në kundërshtim të këtij vendimi , ndërsa më datë 24.10.2023, komisioni i pranimit ka njoftuar kandidatët për rezultatet përfundimtare në lidhje me kandidatët e suksesshëm sipas këtij konkursi , duke i njoftuar palët me të drejtën e ankesës në njësinë përgjegjëse të institucionit në afat prej 3 ditëve , ndaj këtij njoftimi ankuesi ka paraqitë ankesë më datë 25.10.2023 (përkundër që kjo shkresë emërtohet si kërkesë, por se nga qëllimi i palës dhe legjislacioni që i referohet ankuesi ka të bëjë me ankesë), ndërsa komisioni i pranimit referuar kësaj ankese/kërkesë sipas njoftimit të datës 03.11.2023 është njoftuar se kërkesa në kuadër të konkursit ka qenë specifikisht që kandidati të ketë diplomë universitare dhe se e njëjta do të duhej të dorëzohej me aplikacion dhe me qenë se komisioni i pranimit gjatë fazës së vlerësimit ka vërejt se ankuesi nuk ka pasur të bashkangjitur diplomën me rastin e dorëzimit të aplikacionit ka ndalë procedurën e mëtutjeshme të regrutimit në lidhje me këtë ankues/kandidatë, pa lejuar të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike në lidhje me këtë çështje, ndërsa përmes njoftimit të datës 06.11.2023 nga Komisioni i Pranimit është njoftuar për kandidatët e suksesshëm sa i përket këtij procesi të regrutimit, në të njëjtën datë nga SIMBNJ, u njoftua ankuesi për këtë vlerësim, duke udhëzuar ankuesin që në rast se nuk është i kënaqur me këtë rezultat për ushtrimin mund të ushtroj mjetet juridike të paraparë me legjislacionin në fuqi, ndërsa me datë 06.11.2023 me numër protokoll 6876/2023, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se në këtë proces kemi cenim të dispozitave materiale dhe procedurale përkatësisht Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të aplikuar në këtë periudhë, Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji i Këshillit fillimisht bazuar në shkresat e lëndës me rastin e vendimmarrjes mori për bazë shkresën e Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Prishtinës të datës 12.10.2023, përmes së cilës konstatohet se me rastin e aplikimit përkatësisht fazës së verifikimit paraprak nga Njësia e Burimeve Njerëzore janë bërë dy lëshime me që rast në listën e ngushtë kanë hy dy kandidatë, ankuesi dhe kandidati të cilët nuk kanë poseduar diplomat me rastin e dorëzimit të aplikacionit, përkundër që ka qenë një nga kriteret e përgjithshme për pranim sipas këtij konkursi.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni i Pranimit me rastin e nxjerrjes së njoftimit të datës 03.11.2023 që i referohet të drejtës për ankesë në këtë çështje të ankuesit bazuar në njoftimin e datës 24.10.2023 për kandidatët fitues në këtë proces, ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 1 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovës, në të cilat dispozita parashihet: *"1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje",* si dhe në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: "1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;..1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative",* sepse në rastin konkret njoftimi është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje dhe që u potencua më lartë, sepse Komuna e Prishtinës përkatësisht komisioni i pranimit, ka qenë i obliguar që të nxjerr vendim e jo njoftim ashtu siç ka vepruar lidhur me ankuesin në përmbajtje të këtij njoftimi të datës 03.11.2023.

Kolegji i Këshillit, referuar objektit të ankesës konstaton se njoftimi i datës 06.11.2023 për kandidatët fitues sipas këtij konkursi të shpallur nga Komisioni i Pranimit i Komunës së Prishtinës, është bërë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 11 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku shprehimisht parashihet se: *"11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe renditen nga Komisioni i pranimit, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm (në vazhdim: Lista e kandidatëve), e cila publikohet në ëeb faqe",* sepse gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit janë përfshirë në listën e ngushtë dhe intervistim me shkrim edhe kandidatet, ankuesi dhe kandidati

që sipas komisionit të pranimit dhe Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Prishtinës nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit për këtë pozitë, përkundër që ka qenë një nga kriteret e përgjithshme për pranimit sipas këtij konkursi, dhe se në renditjen përfundimtare del se kandidatët e apostrofuara më lartë, ankuesi dhe kandidati janë vlerësuar në testim me shkrim nga Komisioni i Pranimit përkundër që sipas organeve të potencuara më lartë nuk i kanë plotësuar kushtet as për të kaluar fazën e verifikimit paraprak, andaj Kolegji konstaton se ky veprim nga Komisioni i Pranimit për përzgjedhjen e kandidateve është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të potencuar si më lartë. Komisioni i Pranimit i Komunës së Prishtinës në lidhje me këtë konkurs që është objekt i kësaj anekese, me rastin e vlerësimit të kandidatëve përkatësisht njoftimit për kandidatët fitues të datës 06.11.2023 ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 6, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku thuhet se: *"1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive",* si dhe në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet: *"1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore",* e që në rastin konkret nuk janë zbatuar këto procedura përkatësisht janë shkelur dispozitat e potencuara si më lartë.

Kolegji i Këshillit në bazë të konstatimit sa i përket kësaj çështje juridikë, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimi përfshirjes në listën e ngushtë dhe përzgjedhjes përfundimtarë, konstaton se Komuna e Prishtinës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 4, 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës, ku shprehimisht thuhet se: *“4.Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashitohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj”*.

Kolegji i Këshillit, bazuar në shkresat e lëndës dhe nga arsyetimet si më lartë konstaton, gjithnjë bazuar në pretendimet e ankuesit se procedura e rekrutimit nga Komuna e Prishtinës, nga faza e verifikimit paraprak është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa vendimi i komisionit të pranimit i datës 16.10.2023 dhe po ashtu njoftimet e datës 24.10.2023, 03.11.2023 dhe 06.11.2023 janë nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 47 sa i përket strukturës dhe elementeve të detyrueshme të një akti administrativë, nenin 48 që rregullon çështjen e arsyetimit të një akti administrativë , andaj edhe mbi këtë bazë nëse i referohemi nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, këto njoftime nuk mund të prodhojnë pasoja juridike nga se janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të një akti administrativë.

Kolegji i Këshillit me qenë se ka konstatuar shkelje të dispozitave ligjore të potencuara si më lartë nga faza e verifikimit paraprak në këtë proces të rekrutimit dhe pasi ka vendosë që kjo procedurë në lidhje me këtë konkurs të kthehet në fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve përkatësisht vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve që kanë aplikuar për këto pozita ,nga se janë konstatuar parregullsi në këtë fazë përkatësisht në fazën e verifikimit paraprak, andaj nuk është lëshuar në çështje tjera që mund të ndërliken me këtë proces edhe në faza tjera , rrjedhimisht nuk është lëshuar as në vlerësim të kandidatëve që kanë hyrë në listë të ngushtë e po ashtu edhe ata që janë shpallë kandidatë fitues se a i plotësojnë kriteret e përcaktuara me konkurs për këto pozita, andaj është obligim që organet kompetente që nga faza e verifikimit paraprak të respektojnë legjislacionin që rregullon këtë çështje të rekrutimit.

Kolegji i Këshillit, nga ajo që u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi dhe konstatimet në arsyetim të të njëjtit, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës si Njësi Përgjegjëse është e obliguar të rishqyrtoj çështjen lidhur me këtë procedurë, të eliminoj shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe kërkesave të konkursit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësorës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSORËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1383/2023, datë 28/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i lartë për Bashkëpunim profesionale

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokat
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së